

Leica Geosystems

GARANCI NDËRKOMBËTARE E KUFIZUAR

GARANCIA E SHPREHUR PËR HARDWARE. Leica Geosystems AG ("Leica Geosystems"), garanton përdoruesin ("Klientin") se ky Mall nuk ka defekte as në funksionim as në materialin përbërës, po të përdoret në mënyrë normale, për një afat (1) viti, përveç mallrave (i) DISTO™, garancia e të cilave është (2) vjet dhe (ii) bateritë, garancia e të cilave është (90) ditë, në rast se ky afat nuk është zgjatuar nga Leica Geosystem dhe me kusht që të gjitha udhëzimet për funksionimin dhe mirëmbajtjen të zbatohen rreptësisht, sidomos në rastet e tejpërdorimit ose përdorimit të vazhdueshëm të mallit. Periudha e garancisë fillon në datën që provon blerjen (ose, sipas rastit, në datën e dorëzimit të mallit ose në datën që mban fleta e pranimit). I vetmi detyrim i Leica Geosystem në këtë Garanci të Shprehur është zëvendësimi ose ndreqja e mallit, ose e pjesës së tij me shpenzimet e veta ose rimbursimi i çmimit të blerjes së mallit të paguar, sipas zgjedhjes së Leica Geosystems. Leica Geosystems garanton çdo mall të ndrequr ose të zëvendësuar ose pjesë mallrash brenda afatit 90 ditë nga data e dërgimit ose deri në datën e mbarimit të afatit të garancisë, por për këtë efekt do të njihet data më e vonë. Të gjitha mallrat apo pjesët e zëvendësuara kalojnë në pronësi të Leica Geosystems. Kjo garanci e shprehur nuk mbulon pjesët e konsumueshme, si reflektorët, llampat, siguresat dhe as mallrat e të tretëve. Kjo Garanci do të jetë e pavlefshme në rast instalimi, lidhjeje ose përdorimi bashkë me Produktin të ndonjë pajisje tjetër shtesë përveç pajisjeve plotësuese origjinale të autorizuara Leica Geosystems.

GARANCIA E SHPREHUR PËR SOFTWARE. Për "sistem software" (të përkufizuara si software funksionale dhe/ose firmware të nevojshme për vënien në punë dhe funksionimin e Mallit), zbatohen rregullat që zbatohen edhe për Garancinë Ndërkombëtare të Kufizuar të hardware. Kushtet e garancisë që përcaktohen në këtë dokument nuk zbatohen për "Aplikimin e Software" (të përkufizuar si të instaluar paraprakisht apo të futur në programin baze kompjuterik për një funksion të veçantë të mallit dhe/ose të dhënave). Për informacione të mëtejshme për çka mbulon garancia për Aplikimin Software, jeni të lutur ti referoheni Marrëveshjes përkatëse të Licencës Software.

SI MERRET SHËRBIMI I GARANCISË. Klienti duhet të kontaktojë distributorin e autorizuar të Leica Geosystems ose, me përjashtim të mallrave DISTO™, që janë marka tregtare të regjistruara, Qendrën e Shërbimit Leica Geosystem që rekomandon Leica Geosystem, brenda afatit të vlefshmërisë së garancisë, në mënyrë që të marrë autorizim për të drejtën e shërbimit të garancisë. Për këtë kërkohet të provohet data e saktë e blerjes së mallit nga Leica Geosystem apo distributorët e saj të autorizuar si dhe një përshkrim i defektit. Leica Geosystem nuk ka përgjegjësi për mallra ose pjesë mallrash të marra pa autorizim për përfitim të shërbimit të garancisë. Mallrat e ndrequra ose të zëvendësuara i dërgohen klientit me shpenzimet e Leica Geosystems. Malli ose pjesa e ndrequr dërgohet brenda një afati të arsyeshem. Leica Geosystems nuk mban përgjegjësi për dëmtime që ndodhin gjatë transportit. Leica Geosystems vendos vetë se ku do të kryhet puna që mbulohet nga garancia. Për mallrat që janë pjesë e pajisjeve të instaluar në mënyrë fikse, puna do të kryhet në vendin ku ndodhet pajisja e instaluar dhe Leica Geosystems ka të drejtë t'ia faturojë shpenzimet shtesë për këto shërbime që mbulohen nga garancia klientit, nëse vendi i produktit është i ndryshëm nga vendi ku ka qënë dërguar ose instaluar ose dërguar malli.

GARANCIA EKSKLUZIVE. Klienti mund të pretendojë se janë shkelur kushtet e garancisë vetëm në rastet e garancisë së shprehur. Garancia e mësipërme është ekskluzive dhe zëvendëson çdo garanci tjetër, zëvendëson kushte të shprehura ose të nënkuptuara, si të faktit edhe ato të ligjit, detyrimet e njohura me ligj apo mënyra të tjera, përfshirë garancitë, zakonet tregtare, përshtatja për një qëllim të caktuar, përbushja me cilësi dhe mosshkelja e rregullave, çdo garanci që derivon nga përdorimi për tregti, rrjedha e marrëveshjes ose e performancës, çdo garanci që Software është i përputhshëm me cilëndo pajisje të veçantë hardware ose software, që Software do të funksionojë siç duhet në pajisjen e Klientit dhe nuk do të shkaktojë dëme në pajisjen e Klientit apo në të dhënat e tij, dhe çdo garanci se veprimi i Software-it do të jete i pandërprerë dhe "pa gabime", çdo gjë për të cilat është deklaruar shprehimisht mosmbajtja përgjegjësi.

Leica Geosystems nuk mban përgjegjësi nëse defekti i pretenduar është shkaktuar nga keqpërdorimi, pakujdesia, instalimi i gabuar, instalimi, lidhja apo përdorimi bashkë me Produktin i ndonjë pajisjeje tjetër shtesë përveç pajisjeve plotësuese origjinale të autorizuara Leica Geosystems, ndërhyrjet e pautorizuara për hapjen, ndreqjen ose modifikimin e mallit, mirëmbajtja e papërshtatshme, mosrespektimi i udhëzimeve të përdorimit, mbingarkesa apo shtypja e kryer nga Klienti ose persona të tjerë, amortizimi normal e çdo shkak tjetër jashtë kufijve të qelimit të përdorimit, si aksidente, zjarri ose rreziqe të tjera ose shkaqe të tjera që nuk vijnë prej Leica Geosystems dhe as mund ti ngarkohen asaj. Kjo garanci nuk mbulon dëmtimin fizik të mallit ose keqfunksionimin e Mallit që vijnë nga përdorimi i Mallit së bashku me pajisje ndihmëse ose dytësore dhe kur Leica Geosystems deklaronte se Malli nuk ka vese që mund të shkaktonte të tilla dëmtime.

KUFIZIMI I PËRGJEGJËSISË. NË ATË MASË TË LEJUAR NGA LIGJI I ZBATUESHËM, LEICA GEOSYSTEMS PËRJASHTOHET, GJITHASHTU, NGA ÇDO PËRGJEGJËSI, KONTRAKTORE DHE JASHTË PËRVEÇ KONTRAKTORE (PËRFSHIRË PAKUJDESINË E LEHTË DHE MESATRE), PËR DËME RASTËSORE, RRJEDHIMORE, TË TËRTHORTA, TË VECANTA OSE DËME SHITESË TË ÇDO LLOJI OSE NGA DËTYRIMI TË PAGUAJË ÇMIMIN E MALLIT KLIENTIT DHE AS PËR HUMBJEN E TË ARDHURAVE OSE TË FITIMIT, HUMBJEN NË TREGTI, HUMBJEN E TË DHËNAVE OSE INFORMACIONEVE TË TJERA OSE HUMBJE FINANCIARE QË VIJNË DREJTPËRDREJT OSE SI RRJEDHOJË E SHITJES, INSTALIMIT MIRËMBAJTJES PËRDORIMIT, PËRMBUSHJES SË KUSHTEVE, MOSRESPEKTIMIT TË KUSHTEVE OSE NDERPRERJES SË FUNKSIONIMIT TË KËTIJ MALLI DHE NËQOFTËSE LEICA GEOSYSTEMS DINTE MUNDËSINË E DËMTIMEVE TË TILLA DHE KUFIZIMIT E PËRGJEGJËSISË PËR TË ZËVENDËSUAR, NDRËQUR OSE RIMBURSUAR ÇMIMIN E PAGUAR, SIPAS ZGJEDHJES SË LEICA GEOSYSTEM. KY KUFIZIM PËRGJEGJËSIE PËR DËME NUK USHTROHET NËSE PRETENDIMET E SHPREHURA JANË TË PA PAMBËSHTETURA.

JURISDIKSIONI I DISA VENDEVE NUK E LEJON KUFIZIMIN E DËMEVE AKSIDENTALE OSE REZULTUESE. PËR PASOJË KY KUFIZIM MUND TË MOS ZBATOHET. NË RAST SE LIGJI NË FUQI NUK LEJON PËRJASHTIMIN E PLOTË OSE KUFIZIMIN E PËRGJEGJËSISË TË KËRKESAVE DHE DËMEVE SIÇ JANE PËRCAKTUAR ME PARË NË KËTË ÇËSHTJE, PËRGJEGJËSIA ËSHTË E KUFIZUAR NË MASËN MË TË MADHE TË LEJUAR NGA LIGJI NË FUQI. GJITHASHTU NË RAST SE LIGJI NË FUQI E PËRJASHTON

MBULIMIN PËR PERSONELIN NDIHMËS, ATËHERË KY RREGULLIM GJEN ZBATIM.

MOSBAJTJA PERGJEGJESI. Nëse gjykata që ka juridiksion nuk lejon përjashtimin e plotë ose kufizimin e garancive të nënkuptuar ose kufizimi i dëmeve rastësore apo rrjedhimore për disa produkte të furnizuara konsumatorëve ose kufizimin e përgjegjësisë për dëme personale, këto garanci të nënkuptuara dhe përgjegjësi do të kufizohen brenda afatit të vlefshmërisë së garancisë së shprehur.

RREGULLIME PËRJASHTIMORE. Kur pjesë të kësaj garancie shfuqizohen, shpallen nga një autoritet kompetent të pavlefshme, ose të pazbatueshme, ato e shtrijnë fuqinë e tyre të plotë mbi të gjithë garancinë vetëm për pjesën e tyre, ndërkohë që rregullat e tjera e ruajnë efektin. Në këto raste rregullat e garancisë zbatohen në mënyrë të ngjashme, në rast nevojë duke ju dhënë një fuqi vepruese të afërt, për arritjen e një rezultati ligjor të mundshëm, i cili ka qenë edhe qëllimi i rregullimit fillestar të shfuqizuar, të shpallur të pavlefshëm, ose të pazbatueshëm.

Leica Geosystems AG
Heinrich – Wild – Strasse 201
CH – 9435 Heerbrugg
(Zvicër)
www.leica-geosystems.com

Heerbrugg, më 25 mars 2013

PALA E TRETË PËRFITUESE. Palët bien shprehimisht dakord që degët e Geosystems Leica, duke përfshirë edhe subjektin nga i cili klienti ka blerë produktin, janë një palë e tretë përfituese e kësaj Garancie Ndërkombëtare të Kufizuar, si dhe, pa u kufizuar nga sa më sipër, do të ketë të gjitha garancitë mbrojtëse të Leica Geosystems të përfshira në këtë Garancie Ndërkombëtare të Kufizuar.

LIGJI I RREGULLUES DHE JURIDIKSIONI. Kjo garanci rregullohet nga ligjet e Zvicrës, me përjashtim të parimeve të së drejtës ndërkombëtare private dhe të Konventës së Kombeve të Bashkuara për Shitjen Ndërkombëtare të Mallrave të datës 11 prill 1980. Juridiksioni do të jetë në vendin ku Leica Geosystems ka zyrën e saj të regjistruar, pra në Balgach, Zvicër. Leica Geosystems, ka të drejtë të drejtohet gjykatave kompetente të vendit ku banon ose ushtron veprimtarinë tregtare Klienti. Me këtë garanci të kufizuar Leica Geosystems i jep klientit të drejta të posaçme, pa i kufizuar të drejtat ligjore të konsumatorit.